

TRASHËGIMIA KULTURORE NË

FO KU S.

TRASHËGIMIA KULTURORE NË SHQIPË

TRASHËGIMIA
KULTURORE NË **FO
KU
S.**



BOTIMI I TEKSTEVE BURIMORE
MBI PRAKTIKAT E RUAJTJES DHE
MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË
KULTURORE NË GJUHËN SHQIPE

Titulli: “Trashëgimia Kulturore në Fokus: Botimi i teksteve burimore mbi praktikat e ruajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore në gjuhën shqipe”

Botimi është mundësuar nga “Trashëgimia Kulturore pa Kufij Shqipëri” (Cultural Heritage without Borders Albania (CHwB Albania) me mbështetjen financiare të Suedisë nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim.

Përkthimet nga origjinali: Të ndryshëm referuar në çdo dokument përkatësisht

Redaktoi: Boiken Abazi

Parathënie për botimin nga: Elena Mamani, Lorenc Bejko dhe Boiken Abazi

Koordinoi procesin e përkthimeve dhe publikimit:

Elena Mamani, Regina Vathi, Pezana Rexha

Foto: © Bjori Thana, Regina Vathi

Dizajni: Ina (Hina) Shkëmbi, Joniz Osmanagaj

© CHwB Albania © ICOMOS Albania

Viti i botimit: 2023

196 f.: me foto ; 21 x 21 cm

ISBN: 9789928801081

1.Pasuria kulturore 2.Ruajtja dhe restaurimi 3.Menaxhimi 4.Shqipëri

904 :72 .03(496.5)

Shtëpia Botuese: “Graphic Line-01”



This work is distributed under the Creative Commons BY-NC-ND 4.0 licence, which enables re-users to copy and distribute the material in any medium or format in non-adapted form only, for non-commercial purposes only, and only so long as attribution is given to the creator.

Ky botim publikohet bazuar në licencën nga “Creative Commons BY-NC-ND 4.0”, e cila u mundëson ripërdoruesve të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin në çdo mënyrë komunikimi ose format, por vetëm duke mos kryer përshtatje të formës, duke mos e përdorur për qëllime tregtare, si dhe për aq kohë sa i jepet krijuesit atributi përkatës.

DOKUMENTIMI, PREZANTIMI, DHE INTERPRETIMI | KARTË

KARTA E TURIZMIT KULTUROR

Seminari ndërkombëtar mbi turizmin bashkëkohor dhe humanizmin, Belgjikë, 8 dhe 9 nëntor 1976.

ICOMOS

Përkthyer nga: Esmeralda Agolli.
Redaktuar nga: Boiken Abazi.

Versioni origjinal ©ICOMOS. Ky përkthim nuk është përkthim zyrtar ICOMOS-it. Ky përkthim në gjuhën shqipe botohet me lejen e ICOMOS-it, por nën përgjegjësinë e vetme të përkthyesit/botuesit.

Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Sitet (ICOMOS) ka për qëllim të inkurajojë ruajtjen dhe të sigurojë konservimin dhe promovimin e monumenteve dhe siteve - atë pjesë të privilegjuar të trashëgimisë njerëzore.

Në këtë kapacitet, kjo organizatë ndihet e shqetësuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga efektet pozitive dhe negative në trashëgimi të shkaktuara nga zhvillimet ekstreme të aktiviteteve turistike në botë.

Këshilli është i vetëdijshëm se sot përpjekjet e izoluar të kujtdo, sado i fuqishëm qoftë në sferën e vet, nuk mund të ndikojnë në mënyrë domethënëse rrjedhën e ngjarjeve - madje ky lloj ndikimi sot është edhe më i vogël se në të kaluarën. Për këtë arsye ka një përpjekje për të marrë pjesë në një reflektim të përbashkët më gjerë në botë, bashkë me ato organizata rajonale që në një lloj kapaciteti ndajnë të njëjtat shqetësime dhe mund të kontribuojnë në realizimin e një nisme universale, koherente dhe efektive.

Përfaqësuesit e këtyre organizatave u takuan në Bruksel, Belgjikë, më 8 dhe 9 mëntor 1976, në Seminarin ndërkombëtar mbi turizmin bashkëkohor dhe humanizmin dhe ranë dakort si në vijim:

QËNDRIMI THEMELOR

1. Turizmi është një fakt i pakthyeshëm shoqëror, njerëzor, ekonomik dhe kulturor. Ndikimi i tij në sferën e monumenteve dhe siteve është veçanërisht i rëndësishëm dhe është në rritje për shkak të kushteve tashmë të njohura të zhvillimit të këtij aktiviteti.
2. Duke parë perspektivën e njëzet e pesë viteve të ardhshme, në kontekstin e një fenomeni në zgjerim që mund të ketë pasoja të rënda me të cilat do të përballlet raca njerëzore, turizmi duket të jetë një prej fenomeneve që me shumë gjasë do të ndikojë në mënyrë domethënëse të mjedisi njerëzor në përgjithësi dhe tek ai i monumenteve dhe i siteve në veçanti. Në mënyrë që ky ndikim të jetë i përballueshëm, ai duhet të studiohet me kujdes, dhe në çdo nivel të tij duhet të trajtohet përmes politikave të bashkërenduara dhe efektive. Pa pretenduar që këtë nevojë do ta adresojmë në secilin aspekt të saj, përfaqësuesit janë të kënaqur që turizmi kulturor besohet se përbën një element pozitiv në drejtim të zgjidhjes globale që nevojitet.
3. Turizmi kulturor është ajo formë e turizmit që ka

si objekt, përtej synimeve të tjera, edhe zbulimin e monumenteve dhe siteve. Për sa kohë që turizmi kontribuon në mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve dhe siteve, ai ushtron një efekt pozitiv mbi to, duke realizuar njëkohësisht edhe synimet e veta. Në fakt, kjo formë e turizmit justifikon edhe përpjekjet e komunitetit njerëzor për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e monumenteve dhe siteve, për shkak të përfitimeve socio-kulturore dhe ekonomike që sjell për të gjithë popullsitë përkatëse.

4. Cilido qoftë motivi dhe përfitimet, sado qofshin ato, turizmi kulturor nuk mund të konsiderohet i ndarë nga ndikimet negative, prishëse dhe shkatërruese që vinë nga përdorimi masiv dhe i pakontrolluar i monumenteve dhe siteve. Respektimi i tyre kërkon përcaktimin dhe zbatimin e standardeve të pranueshme, ashtu siç veprohet edhe për përmbushjen e dëshirës bazë për t'i mirëmbajtur ato në një gjendje të mirë që u lejon të luajnë rolin e tyre si pika tërheqëse turistike dhe forma të edukimit kulturor.

Në çdo rast, duke patur të ardhmen në mendje, respekti ndaj trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore duhet të ketë përparësi mbi çdo vlerësim tjetër, sado i justifikuar të mund të duket nga pikëpamja sociale, politike, ose ekonomike.

Për të siguruar këtë lloj respekti, ka nevojë për rregulla që përcaktojnë vendosjen e pajisjeve dhe udhëzimeve për lëvizjen e turistëve lidhur me kufizimet e përdorimit dhe të densitetit. Këto janë rregulla të cilat nuk duhet të lejohet të anashkalohen pa masa ndëshkuese, megjithatë edhe këto rregulla nuk mjaftojnë për të siguruar respektin e duhur.

Për më shumë, nevojitet zbatimi i masave ndëshkuese për vendosjen e atyre pajisjeve apo shërbimeve turistike që janë në kontradiktë me shqetësimet themelore që lidhen me respektin që ne i detyrohemi trashëgimisë kulturore ekzistuese.

ARGUMENTET BAZË PËR VEPRIM

Duke u mbështetur në sa më sipër:

- organizatat që përfaqësojnë turizmin, në njërin anë, dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe monumentale, në anën tjetër, janë thellësisht të bindura se mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në dobi të shumicës nuk mund të sigurohet

ndryshe përveçse në një mënyrë të rregulluar, d.m.th duke integruar pronat kulturore brenda objektivave sociale dhe ekonomike që bëjnë pjesë në planifikimin e burimeve shtetërore, rajonale dhe të komuniteteve në nivel lokal.

- pranojnë me interesin më të madh masat që secila organizatë ka deklaruar se është e gatshme t'i ndër-marrë brenda sferës së ndikimit të saj, siç është e shprehur në shtojcën e kësaj Deklarate.
- i bëjnë apel vullnetit të shteteve për të siguruar zbatimin e shpejtë dhe energjik të Konventës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore (miratuar më 16 nëntor 1972) dhe të Rekomandimeve të Nairobit.
- shprehin besimin se Organizata Botërore e Turizmit, në përmbushje të qëllimeve të saj, dhe UNESCO-ja, në kuadër të Konventës së përmendur më lart, do të bëjnë të gjitha përpjekjet në bashkëpunim me organizatat nënshkruese të kësaj Deklarate, si dhe të gjithë ata që mund të bashkohen në të ardhmen, për të siguruar zbatimin e politikave që organizatat nënshkruese kanë përcaktuar si të vetmet që mund ta mbrojnë Njerëzimin nga efektet e rritjes anarkike të turizmit – efekte që çojnë edhe në mosrealizimin e objektivave të turizmit.

Ato shprehin dëshirën që, me anë të strukturave administrative, organizatave të operatorëve turistikë dhe shoqatave të palëve të interesit, shtetet të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të lehtësuar marrjen e informacionit dhe zhvillimin e trajnimeve për njerëzit që udhëtojnë për qëllime turistike brenda dhe jashtë vendit të tyre të origjinës.

Të vetëdijshme për nevojën akute për ndryshimin e sjelljes së publikut të gjerë në lidhje me fenomenet që krijohen nga zhvillimet masive të nevojave turistike, ato shprehin dëshirën që fëmijët e moshës shkollore dhe adoleshentët të arsimohen për t'i kuptuar dhe respektuar monumentet, shtetet dhe trashëgiminë kulturore, si dhe që i gjithë informacioni me shkrim, me gojë apo me materiale pamore duhet t'i komunikojë publikut elementet e këtij problemi, dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në të kuptuarit efektiv dhe universal të çështjes.

Duke shprehur në mënyrë unanime shqetësimin e tyre për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, e cila është

edhe baza e turizmit ndërkombëtar, ato angazhohen të ndihmojnë në luftën e nisur në të gjitha frontet kundër burimeve të njohura të ndotjes që shkatërrojnë trashëgiminë; dhe ato i bëjnë apel arkitektëve dhe ekspertëve shkencorë të të gjithë botës që të përdorin burimet më të përparuara të teknologjisë moderne për ruajtjen e monumenteve.

Ato rekomandojnë që specialistët që do të thirren për të konceptuar dhe zbatuar përdorimin turistik të trashëgimisë kulturore dhe natyrore duhet të marrin formimin e volitshëm profesional për natyrën shumëplanëshe të llojit të kësaj çështjeje, dhe se gjithashtu duhet të jenë të përfshirë që prej fillimit në programin dhe zbatimin e planeve zhvillimore dhe turistike.

Në mënyrë solemne ato deklarojnë se veprimet e tyre ndërmerren për respektimin dhe mbrojtjen e autenticitetit dhe larmisë së vlerave kulturore në rajonet dhe vendet në zhvillim, ashtu si edhe në kombet e industrializuara, duke qënë se fati i trashëgimisë kulturore të Njerëzimit ka të njëjtën natyrë kudo, marrë parasysh zgjerimin e pritsëm të turizmit.